



Pranuar / Dorezuar / Prijmljeno / Predato / Received / Delivery	06.07.2022	2	viti god year
Organ / Shista / Organ / Jednica / Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKANSHEK	3966/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.536/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.536/2022 të datës 15.06.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë banimi _____ kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike“ kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 , nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.DETYROHET Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 06.09.2021 të parashtruar nga ankuesja _____ brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

II.OBLIGOHET Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

III.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ më datë 15.06.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër mos nxjerrje së vendimit nga Komisioni për Grada dhe Disipline, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.06.2022, ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë 29.06.2022 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes administroi këto prova: Ankesën e datës 15.06.2022, e parashtruar nga ankuesja me numër protokollit 3508/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 15.06.2022; E-mail zyrtar i datës 15.06.2022 qasje në procesverbal; Vendimi i datës 15.06.2022 me numër protokollit 2212 për lejimin e qasjes në dokumente zyrtare; E-mail zyrtar i datës 15.06.2022 ; Ankesë për mos marrjen e gradës e datës 07.02.2022 me numër protokollit 332; për komisionin për grada; Kërkesë për gradë e datë 06.09.2021 për Komisionin për Grada dhe Disiplinë –MPJD; Ftesësë për shprehje të interesit për gradim nga data 03.09.2021 deri më datën 08.09.2021; Kërkesë e datës 16.09.2020 për Komisionin për Grada dhe Disiplinë; E-mail zyrtar i datës 17.09.2020; E-mail zyrtar i datës 11.09.2020; Formulari për vlerësimin e punës provuese; Divizioni për viza; Letër reference për datës 29.03.2018; Akt emërimi i datës 04.12.2019; Akt emërimi i datës 29.11.2018; Përgjigje në ankesë e datës 29.06.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 3794/2022 bashkë me shkresat e lëndës fae 1/42; Fletëkthesa e datës 19.06.2022; Akt emërimi daës 13.06.2022; Letër motivimi e datës 06.09.2021; Çertifikatë e datës 11.03.2020; Çertifikatë e datës 12.04.2019; Çertifikatë e datës 11.04.2019; Çertifikatë e datës 08.09.2020; Çertifikatë e datës 20.06.2019; Çertifikatë e datës 05.03.2014; Çertifikatë e datës 14.01.2019; Çertifikatë e datës 11.03.2020 dhe Cv për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht Komisionin për Grada dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative në pajtim me kompetencat ligjore që ka, për të vendosur lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 06.09.2021 të parashtruar nga ankuesja drejtuar Komisionit për Grada dhe Disipline pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kërkesë e cila ishte parashtruar pas njoftimit nga ana e Zyrës së Sekretarit të MPJD-së e datës 03.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me parashtrimin e kërkesës së ankueses të datës 07.09.2021 ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”* në pajtim me mandatin ligjor që ka duke iu referuar Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës neni 30 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ku përcaktohet se: *“Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm”* në mbështetje edhe të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: *“Gradimi në pozita më të larta dhe rritja në baza të meritave do të shqyrtohet nga Komisioni”* ndërlidhur me nenin 12 paragrafit 2 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *“Komisioni ka për*

detyrë që të bëjë vlefshmërinë e caktimit të gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore”.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstatuar se pas pranimit të Vendimit të KPMSHCK-së, organi i punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës respektivisht Komisioni për Grada dhe Disiplinë, duhet të shqyrtojë kërkesën dhe të veproje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji nr. 03/1-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, pasi që na bazë të procesverbalit të datës 02.12.2021 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të cilin ankuesja pas kërkesës për qasje në dokumente publike ka arritur ta ketë në posedim me datë 15.06.2022, të njëjtët nuk ka vendos sipas obligimeve ligjore që kanë duke nxjerr akt administrativ përmes të cilit i pranohet apo i refuzohet kërkesa për avancim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.536/2022, datë 06.07.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueset
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

